



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:096652
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05501650

C.nr.290/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, në çështjen juridike të paditësve J.H dhe D.K, që të dy nga fshati Krushë e madhe, komuna Rahovec, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor avokat B.O, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 1,314.60 €, jashtë seance, më 25.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET padia dhe kërkesëpafia e paditësve **J.H** dhe **D.K** në tërësi si e bazuar si dhe:

OBLIGOHET e paditura Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që:

Paditësit **J.H** për periudhën kohore, 21.01.2021 e deri më datë 21.11.2022, t'ia paguajë në emër të Shpenzimeve për udhëtim për 312 ditë punë për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacione në shumë prej 3 euro të i paguaj shumen prej 655.20 Euro (70% i 3,00 euro= 2,10 euro x 312 ditë pune = 655.20 euro), me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt.25.04.2023 e deri në pagesën definitive e brenda afatit prej 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim.

Paditësit **D.K** për periudhën kohore, 21.01.2021 e deri më datë 21.11.2022, t'ia paguajë në emër të Shpenzimeve për udhëtim për 314 dite punë për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacione në shumë prej 3 euro të i paguaj shumen prej 659.40 Euro (70% i 3,00 euro= 2,10 euro x 314 ditë pune = 659.40 euro), me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt.25.04.2023 e deri në pagesën definitive e brenda afatit prej 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim.

DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 187.00 € me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit J.H dhe D.K, nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar me datë 25.04.2023 kësaj gjykate i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se janë në marrëdhënie pune në SHFMU “Skender Kastrati” në fshatin Radoste, Komuna e Rahovecit, e që për periudhën e kërkuar paditësit i ka takuar e drejta e kompensimit të udhëtimit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 21.01.2021, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është 21.01.2021 e deri me datë 21.11.2022 dhe atë 312 dhe 314 ditë të prezencës në punë.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 16.08.2023, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrihen tek punëdhënësi. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditësit nuk kanë parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: për paditësin **J.H** ka bërë vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 02/615/2023 i datës 04.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Skender Kastrati” në fshatin Radoste, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit J.H; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i datës Shkurt 2023, i lëshuar nga SH.T; certifikata e vendbanimit e datës 02.03.2023, për paditësin **D.K** ka bërë shikimin në vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 02/607/2023 i datës 04.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Skender Kastrati” në fshatin Radoste, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit D.K; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i datës Shkurt 2023, i lëshuar nga SH.T; certifikata e vendbanimit e datës 02.03.2023.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë ka proceduar vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 02/615/2023 i datës 04.04.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi J.H në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 312ditët e punës.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësit J.H dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Skender Kastrati” në fshatin Radostë, Komuna e Rahovecit.

Me shikimin e vërtetimit e çmimit të biletës së udhëtimit i datës Shkurt 2023, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Krushë – Radoste- dhe anasjelltas është 3.00 euro në dy drejtime.

Me shikimin e certifikatës së vendbanimit Nr. Ser.B 10441268 e datës 02.03.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi jeton në fshatin Krushë e madhe komuna Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 02/607/2023 i datës 04.04.2023,, gjykata vërtetoi faktin se paditësi D.K në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 314 ditët e punës.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësit D.K dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Skender Kastrati” në fshatin Radoste, Komuna e Rahovecit.

Me shikimin në vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i datës Shkurt 2023, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Krushë e madhe – Radostë si dhe anasjelltas, çmimi 3.00 €, në dy drejtime.

Me administrimin e certifikatës së vendbanimit Nr. ser. B 10441267, e datës 02.03.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi D.K jeton në fshatin Krushë e madhe, komuna Rahovec.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve për faktin se paditësit në periudhën kohore nga data 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tyre të punës kanë prezantuar në 312 dhe 314 ditët e punës. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”.

Ndërsa sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Duke vërtetuar në këtë mënyrë gjendjes faktike me prova materiale bindëse, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, kjo gjykatë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që e paditura t’ia kompensoj paditësve shumën prej 187.00 €, e që kanë të bëjnë: për përpilimin e padisë shumën prej 156.00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 21,00 €.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.290/2023, më 25.03.2024

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil